



REPUBLIKA E SHQIPERISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.94, Datë 04.07.2017

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS NR. 176, SERIA T12 TË SHOQËRISË “DANSKE
COMMODITIES ALBANIA” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 13 dhe nenit 16 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënie, Modifikimi, Transferimi, Rinovimi ose Heqjen e Licensave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 e “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 04.07.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për rinovimin e licencës nr. 176, Seria T12 të shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:

Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 71, datë 11.05.2017, filloi procedurën për rinovimin e licencës nr. 176, Seria T12 të Shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k, në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

Aplikimi i shoqërisë “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” sh.p.k, ka plotësuar kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Rinovimin e licencës nr. 176, Seria T12 të shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5 (pesë) vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI